

# KONTRATË BASHKËPUNIMI

Kjo Kontratë Bashkëpunimi (në vijim “Kontrata”) lidhet sot, më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_\_, ndërmjet:

**West Tourism Sh.p.k – West Travel Albania**, agjenci udhëtimi me seli në Rruga Frederik Shiroka, Tiranë, Shqipëri, me NIPT: M52007019U, (në vijim “Agjencia”)

dhe

**Klienti:** \_\_\_\_\_, Nr. ID / Pasaportë / NIPT: \_\_\_\_\_, Adresa: \_\_\_\_\_, Tel / Email: \_\_\_\_\_, (në vijim “Klienti”).

Agjencia dhe Klienti, së bashku referuar si “Palët”.

---

## NENI 1 – OBJEKTI I KONTRATËS

1.1 Objekti i kësaj Kontrate është rregullimi i marrëdhënies së bashkëpunimit ndërmjet Palëve për ofrimin nga Agjencia të shërbimeve turistike për Klientin, duke përfshirë por pa u kufizuar në: - Rezervime fluturimesh; - Rezervime hotelesh; - Paketa turistike; - Transferta; - Siguracione udhëtimi; - Shërbime vizash (kur aplikohet); - Shërbime të tjera turistike sipas kërkesës së Klientit.

Destinacioni: \_\_\_\_\_

Kohëzgjatja: \_\_\_\_\_ ditë / \_\_\_\_\_ netë

Transporti: \_\_\_\_\_

Akomodimi: \_\_\_\_\_

Shërbime të përfshira: \_\_\_\_\_

---

## NENI 2 – DETYRIMET E AGJENCISË

2.1 Agjencia angazhohet të ofrojë shërbimet e kërkuara në mënyrë profesionale dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2.2 Agjencia do të informojë Klientin për: - Detajet e udhëtimit; - Kushtet e anulimit dhe ndryshimit; - Politikat e furnitorëve (linja ajrore, hotele, operatorë turistikë); - Dokumentacionin e nevojshëm për udhëtim, detajet e nisjes dërgohen të paktën një ditë përpara udhëtimit në kontaktet tuaja

2.3 Agjencia nuk mban përgjegjësi për vonesa apo ndryshime në itinerar si pasojë e kushteve atmosferike apo faktorëve të tjerë jashtë kontrollit (forcë madhore), renditja e ekskursioneve mund të ndyshojnë në varësi të disponibilitetit.

2.4 Agjencia nuk mban përgjegjësi për ndryshime në oraret e nisjes dhe mbërritjes të ndyshuar nga kompania ajrore, Çdo ndryshim i orareve të fluturimeve nga ana e kompanive ajrore do t’ju komunikohet në kohë reale.

2.5 Agjencia nuk mban përgjegjësi për pasagjerët që ndalohen apo kthehen nga autoritetet kufitare për arsye të tilla si mungesa e dokumentacionit të duhur, dëbim (espuls), etj.

2.6 Udhëtarët nën moshën 18 vjeç që udhëtojnë pa të dy prindërit, duhet të pajisen me prokurë të noterizuar (në dy kopje)

2.7 Pasaporta duhet të ketë vlefshmëri minimale prej 3 ose 6 muajsh nga data e kthimit të udhëtimit sipas shteteve perkatëse

2.8 Vendosja e pasagjerëve në avion bëhet automatikisht gjatë Check-In-it ne Desk

---

## NENI 3 – DETYRIMET E KLIENTIT

3.1 Klienti angazhohet të japë informacion të saktë dhe të plotë për të dhënat personale dhe dokumentet e udhëtimit.

3.2 Klienti është përgjegjës për: - Vlefshmërinë e pasaportës; - Vizën (kur kërkohet); - Respektimin e rregullave të vendit pritës.

3.3 Klienti angazhohet të kryejë pagesat sipas afateve të përcaktuara.

---

## NENI 4 – ÇMIMI DHE PAGESA

4.1 Çmimi i shërbimeve përcaktohet sipas ofertës së konfirmuar nga Agjencia.

4.2 Për të proçeduar me rezervimin kërkohet pagesë e menjëherëshme, ose një parapagim prej 70% të shumës totale; pjesa e mbetur duhet të shlyhet jo më vonë se 20 ditë para nisjes (Në varesi të llojit të shërbimit të ofruar).

4.3 Pagesat e kryera janë të pakthyeshme.

4.4 Pagesa kryhet:

- Me para në dorë; - Me transfertë bankare; - Me kartë bankare (kur aplikohet).

4.5 Moskryerja e pagesës brenda afatit sjell anulimin automatik të rezervimit.

---

## NENI 5 – ANULIME DHE NDRYSHIME

5.1 Çdo anulim ose ndryshim bëhet sipas rregullave të furnitorëve përkatës.

5.2 Penalitetet për anulim apo ndryshim i faturohen Klientit.

5.3 Agjencia nuk mban përgjegjësi për kostot e shkaktuara nga anulimet e detyruara për arsye jashtë kontrollit të saj.

---

## NENI 6 – FORCA MADHORE

6.1 Asnjëra Palë nuk mban përgjegjësi për mosrealizim të detyrimeve për shkak të forcës madhore (pandemi, fatkeqësi natyrore, konflikte, vendime qeveritare, etj.).

---

## NENI 7 – MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

7.1 Agjencia angazhohet të ruajë dhe përpunojë të dhënat personale të Klientit në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

---

## NENI 8 – ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

8.1 Çdo mosmarrëveshje do të zgjidhet fillimisht me mirëkuptim.

8.2 Në rast mosmarrëveshjeje të pazgjidhur, kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

---

## NENI 9 – DISPOZITA TË FUNDIT

9.1 Kjo Kontratë hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga të dyja Palët.

9.2 Kontrata hartohet në dy (2) kopje origjinale, nga një për secilën Palë.

9.3 Çdo ndryshim i Kontratës bëhet vetëm me shkrim dhe me dakordësi të Palëve.

---

**AGJENSIA**

**KLIENTI**

---

Emër, Mbiemër, Firmë

Data: \_\_\_\_\_

Emër, Mbiemër, Firmë

Data: \_\_\_\_\_